



KONFERENCA
Diaspora Flet

ANALIZË E SHKURTËR E POLITIKAVE MBI
**MËSIMIN PLOTËSUES
NË GJUHËN SHQIPE**

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Germin dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

© 2018 Germin

Pa lejen me shkrim nga Germin asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthimi, të transmetohet në ndonjë formë ose me çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjimi, incizimi ose ndryshe.

Prishtinë, 2018

Analizë e shkurtër e politikave mbi mësimin plotësues në gjuhën shqipe

I. Situata Aktuale

Kultivimi i identitetit kombëtar është e drejtë themelore njerëzore. Shenja e parë dhe më e rëndësishme e këtij identiteti është gjuha amtare. Mësimi i gjuhës amtare në shkollë nënkupton edhe mësimin për kulturë, traditat, dhe prejardhjen dhe luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin gjuhësor dhe identitetin e fëmijës gjithashtu është përkrahës i dy gjuhësisë apo shumë gjuhësisë.

Në kushtet e jetës jashtë atdheut, ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar vështirësohet dhe kjo manifestohet shumë më tepër te brezat e rinj, posaçërisht te fëmijët e lindur atje. Prandaj, institucioni më i përshtatshëm, ku mësohen e zhvillohen kompetencat gjuhësore e kulturore me përkujdesje profesionale, është shkolla[1]. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në kohën e pasluftës ka punuar që të shtyjë përpara mësimin plotësues në gjuhën shqipe, në vendet ku jeton diaspora shqiptare. Kjo është bërë përmes hartimit të kurrikulës, krijimit të kontakteve me shoqatat e diasporës nëpër vendet e huaja, dhe hartimin e planeve të veprimit. Megjithatë, deri më sot mësimi plotësues në gjuhën shqipe nuk është i përhapur në nivelin e kërkuar. Fëmijët në diasporë vazhdojnë të mos mbajnë/vijojnë orë plotësuese të gjuhës shqipe, si pasojë e sfidave të ndryshme, përfshirë mungesën e financimit, mungesa e materialeve adekuate edukative, si dhe mungesa e mësimitdhënësve të kualifikuar. Në tërësi, nuk ekziston një sistem i mirëfilltë i mësimin të gjuhës shqipe i vendosur nga ana e institucioneve shtetërore. Ky dokument ka për qëllim të përmbledhë kornizën ekzistuese në fuqi mbi mësimin plotësues, duke vënë në pah sfidat të cilat hasen në këtë aspekt. Gjithashtu, në dokument ofrohen edhe shembuj nga shtetet tjera, siç janë Kroacia e Maqedonia, për financimin dhe organizimin e mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Në fund ofrohen rekomandime për institucionet relevante.

II. Korniza ligjore

[Liqji Nr. 04/ L - 095 për Diasporën dhe Mërgatën](#) është ligji bazë i cili rregullon ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës, dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet e Republikës së Kosovës. Në këtë aspekt, ky ligj parasheh themelimin e Qendrës Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën (QKKDM) me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e

arsimor të mërgimtarëve dhe të forcojë lidhshmërinë e tyre me institucionet e Republikës së Kosovës. Ndër përgjegjësitë kryesore të QKKDM-së është të nxisë dhe zhvillojë njohuri për gjuhët.

Më tutje sipas ligjit, Ministria përkatëse për diasporë ka për detyrë që të ndihmojë në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gjuhët e komuniteteve tjera në të cilat zhvillohet sistemi arsimor në Kosovë. Ministria për realizimin e procesit arsimor, duhet t'i bashkërenditë dhe koordinojë punët me vendet e rajonit me interesa të përbashkëta.

Për sa i përket pikës së fundit, në janar të vitit 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ajo e Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar një Marrëveshje për Bashkëpunim në Fushën e Diasporës. Ndër pikat kyçe të bashkëpunimit është edhe fusha e mësimin të gjuhës shqipe për fëmijët e mërgatës shqiptare, përfshirë mbështetja e aktiviteteve kulturore-artistike për promovimin e kulturës shqiptare, forcimi i identitetit kombëtar në vendet pritëse, si dhe hapja e një qendre botuese për librat në gjuhën shqipe të cilat dërgohen për përdorim në shkolla në diasporë [2].

Në anën tjetër, për të promovuar mësimin plotësues në gjuhën shqipe, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka hartuar Kurrikulën e Shkollës Shqipe të Mësimin Plotësues në Diasporë, e cila në i dedikohet fëmijëve dhe të rinjve (nxënësve) shqiptarë të cilët jetojnë jashtë atdheut[3]. Ky dokument është pjesë e synimit të përhershëm për vetëdijesimin e vazhdueshëm të brezave të rinj për gjuhën dhe kulturën e origjinës, si përparësi dhe veçanti e identitetit të tyre personal e kolektiv kombëtar, në njërin anë, dhe si mbështetje e bazë e mirë për integrimin e tyre në shoqërinë ku jetojnë, në anën tjetër.

III. Analizë krahasuese me praktikën në vendet tjera

Në tabelën në vijim janë krahasuar dispozitat e mësimin plotësues në disa vende të cilat e kanë këtë proces më të zhvilluar. Qëllimi i kësaj tabele është që të tregojë se çka mund të synojnë institucionet e Kosovës kur avokojnë tek shtetet pritëse lidhur me ofrimin e kushteve për mësim plotësues në gjuhën shqipe.

	Kroacia	Suedia	Mbretëria e Bashkuar
Struktura e mësimit plotësues	Deri në 2 orë në javë mësimit plotësues, i cili ofrohet nga shkolla përkitazi me nevojat/interesat e nxënësve, dhe pas aprovimit nga Ministria e Arsimit[4]	Shteti ofron mësimit plotësues për gjuhë amtare pos suedishtes në shkolla. Për mësimit plotësues përgjegjëse për organizim është komuna. Mësimdhënësit punësohen në bazë të nevojës dhe nuk kanë normë të plotë[5]	Mësimi plotësues zhvillohet totalisht në baza vullnetare, nëpër organizata të komunitetit.
Kurrikulat	Kurrikula është e ngjashme me atë të mësimit të gjuhëve të huaja, të nxjerra nga Ministria e Arsimit. Mësimi fillon vetëm në ciklin e dytë (klasat 5-8).[6]	Kurrikulat përmbajnë vlerat, detyrat, qëllimet, dhe udhëzimet për mësimdhënie. Para hyrjes në fuqi, ai duhet të aprovohet nga Agjencia Kombëtare Suedeze për Arsim. [7]	Nuk ka kurrikulë zyrtare. Përmbajtja e orëve mësimore vendoset në baza ad-hoc nga ana e mësimdhënësve.
Financimi	Mësimi plotësues financohet nga buxheti i shkollave; hapësirat, materialet, dhe mësimdhënësit paguhen nga shkolla[8].	Qeveria e financon mësimit plotësues për gjuhë amtare, me një buxhet prej 200 mijë eurosh në vit[9]	Zakonisht këto organizata me bazë në komunitet kërkojnë që anëtarët e tyre të paguajnë anëtarësi.

IV. Sfidat kryesore

Duke u nisur nga niveli i shpërndarjes të mësimit plotësues në diasporën shqiptare, është mjaft e qartë se sfidat janë të numërta. Në vijim janë paraqitur sfidat kryesore të cilat mund të thuhet se kanë penguar vazhdimisht zhvillimin e mësimit plotësues në gjuhën shqipe:

a. Financimi i mësimit plotësues në gjuhën shqipe

Deri më sot, një ndër sfidat kryesore tek mësimit plotësues në gjuhën shqipe ka vazhduar të jetë financimi. Përderisa në njërin anë, organizimi i mësimit plotësues kërkon resurse financiare dhe kohore, në anën tjetër, me organizim të duhur dhe shfrytëzim të mirë të resurseve, kjo nuk do të kërkojë financim shumë të madh. Mësimdhënësit shqiptarë në diasporë kanë ngritur një numër të sfidave të cilat burojnë nga financimi.

Fillimisht, edhe në rastet kur mësimit plotësues organizohet në baza vullnetare nga ana e mësimdhënësve, mungesa më e madhe vërehet tek materialet mësimore. Në shumë raste,

mësimdhënësit kanë vështirësi të sigurojnë materialet e duhura, apo t'i sjellin ato nga vendet shqipfolëse – si Shqipëria apo Kosova. Si rrjedhojë, shpeshherë, nxënësit e niveleve të ndryshme mësojnë me materiale të ndryshme. Më tutje, tek financimi është problem edhe kompensimi i mësimdhënësve. Si rezultat i mungesës së një sistemi të mësimit plotësues, dhe rrjedhimisht zhvillimit të mësimit plotësues në baza vullnetare, mësimdhënësit gjithashtu nuk kompensohen për punën e bërë. Pra, përpos në disa shtete, siç janë Austria dhe Suedia, ku shteti i paguan mësimdhënësit për të ligjruar në gjuhën amtare, në shumicën e vendeve tjera mësimdhënësit shqiptarë e bëjnë këtë në baza vullnetare. Më tutje, duhet të kihet parasysh edhe fakti se ka dallime në mënyrën e financimit brenda një shteti. Për shembull, në Gjermani në disa rajone pagesa bëhet komplet nga institucionet shtetërore, ndërsa në të tjerat jo. Kjo pastaj inkurajon pabarazi mes mësimdhënësve fillimisht, dhe shtrirjes së mësimit plotësues në gjuhën shqipe në përgjithësi. E njëjta, gjithashtu mund të rezultojë edhe në mungesë të konsistencës dhe rrjedhshmërisë së mësimit.

Momentalisht, dy qeveritë – ajo Shqiptare dhe ajo e Kosovës – kanë deklaruar se financimin e mësimit plotësues do ta adresojnë përmes marrëveshjes për bashkëpunim, e cila është nënshkruar nga ana e dy Qeverive. Deri më tani, nuk është parë të jetë marrë ndonjë hap konkret në këtë drejtim.

b. Kurikula dhe kualifikimi i mësimdhënësve

Përpos sfidave që lidhen me financim të mësimit plotësues, në realitet janë evidente edhe sfidat substanciale lidhur me këtë të fundit. Në këtë aspekt, mund të përmendim kurikulën e mësimit, kualifikimin e mësimdhënësve, si dhe pjesëmarrjen aktive nga ana e nxënësve.

Nga diskutimi virtual i organizuar nga Germin me këtë temë dhe nga grupet e fokusit, të organizuara në 11 qytetet e Evropës & ShBA-së është potencuar se mësimdhënësit e diasporës kanë theksuar nevojën e madhe për përditësim të kurikulës për të reflektuar metoda të reja të nxënies. Kjo, pasi deri më tani është punuar me kurikula të ndryshme dhe jo të unifikuara të cilat nuk kanë ofruar mundësi të përshtatjes me metodat e reja të mësimit. Gjithashtu, së bashku me këtë kërkesë, është ngritur edhe kërkesa për dizajnim të materialeve të reja mësimore, të ndara në nivele, të cilat pastaj do të mund të përdoren me kurikulën e re dhe metodat e reja. Vlen të theksohet se nga anketa e Germin mbi mësimin plotësues me 157 respondentë, kuptojmë se rreth 49% të respondentëve janë deri diku të kënaqur me nivelin e përkrahjes nga Minsitria e Diasporës për mësimin plotësues, si për shembull në aspekt të dërgimit të librave.

Pas shumë e shumë diskutimesh nga ana e diasporës shqiptare, së voni kemi parë nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë, një përpjekje për unifikimin e kurikulës së mësimi. Sipas përfaqësuesve të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, ky proces është në përfundim e sipër, dhe si i tillë duhet aprovuar nga ana e Qeverisë para se të jetë në fuqi. Pjesëmarrja e nxënësve nëpër klasa të mësimi plotësues mbetet shqetësuese. Mësimdhënësit thonë se nuk ka numër adekuat dhe se nxënësve ju mungon motivi për të marrë pjesë nëpër këto klasa. Në këtë drejtim, anketa e zhvilluar nga Germin tregon se rreth 75% të të anketuarve janë deklaruar se preferojnë nëse mësimi plotësues në gjuhën shqipe përfshihet në orarin e rregullt mësimor. Andaj, dizajnimi i orëve në këtë mënyrë mund të rriste mbase pjesëmarrjen e nxënësve nëpër to. Pastaj si rezultat i kësaj, mësimdhënësit kanë thënë se detyrohen që të vendosin nivele të ndryshme të nxënësve në një klasë, duke shkaktuar kështu konfuzitet dhe ulje të efektshmërisë së mësimi. Gjithashtu, si rezultat i anketës së, të pyetur se sa janë të kënaqur me kualitetin e mësimi plotësues jashtë vendit, 63% të respondentëve kanë mendim netural për kualitetin e mësimi plotësues të gjuhës shqipe në Diasporë (mirë+deri diku mirë). Në anën tjetër, rreth 13% e të anketuarve e vlerësojnë kualitetin e mësimi plotësues si "shumë të mirë," ndërsa rreth 24% si "aspak të mirë."

c. Bashkëpunimi me Shtetet tjera

Sipas Ligjit për Diasporën, Ministri i Diasporës nënshkruan marrëveshje bilaterale me vendet përkatëse ku jetojnë pjesëtarët e diasporës së saj, për organizimin e procesit mësimor të gjuhëve zyrtare dhe kulturës së Republikës së Kosovës dhe në gjuhët e komuniteteve tjera në të cilat zhvillohet sistemi arsimor në Kosovë

Në këtë aspekt, mund të thuhet se hapi më inkurajues i ndërmarrë, është nënshkrimi i Marrëveshjes me Shqipërinë, e cila u përmend më lartë. Megjithatë, kjo marrëveshje paraqet bashkëpunimin vetëm në korniza të trasha dhe lë shumë specifika që të vendosen nga ana e institucioneve përkatëse. Për shembull, mësimdhënësit e diasporës, janë deklaruar vazhdimisht se nuk ka ndonjë mekanizëm mbikëqyrës i cili verifikon cilësinë e mësimdhënies ose metodave të përdorura. Gjithashtu, është cekur se ka një mungesë shumë të madhe të bashkërenditjes së aktiviteteve të shoqatave të ndryshme të diasporës – qofshin ato lidhur me mësimin plotësues apo me aktivitete të tjera shkencore, kulturore, e artistike.

Më tutje, për sa i përket bashkëpunimit, Kosova nuk mund të thuhet se ka themeluar bashkëpunim serioz me ndonjërin nga shtetet pritëse të diasporës shqiptare, lidhur me mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Mungesa e bashkëpunimit institucional me këto vende,

i pamundëson Kosovës që të rekomandojë atyre shteteve ndërmarrjen e masave nxitëse për pjesëmarrje të nxënësve në mësimin plotësues. Për shembull, në rolin e shtetit pritës, Kroacia u jep pikë shtesë për regjistrim në shkollën e mesme të gjithë nxënësve që kanë ndjekur me rregull mësim plotësues të gjuhës së tyre anëtare në shkollën fillore. Në këtë kontekst, një bashkëpunim i tillë me shtetet pritëse më të mëdha për diasporën shqiptare është i nevojshëm. Për të plotësuar këtë dokument politikash me informacione të drejtpërdrejta nga Ministria e Diasporës, Germin ka provuar që të marrë përgjigje nga ana e tyre lidhur me mësimin plotësues, mirëpo një gjë e tillë ka qenë e pamundur. Fatkeqësisht, e njëjta vlen edhe për qasjen e Ministrisë së Arsimit, nga e cila gjithashtu nuk është hasur në gatishmëri bashkëpunimi në formën e ofrimit të inuteve për këtë dokument.

V. Rekomandimet


Në vijim të sfidave kryesore lidhur me mësimin plotësues që u ngritën në këtë dokument, rekomandohet që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin hapat në vijim për të adresuar këto sfida. Rekomandimet përfshijnë edhe ato të cilat janë nxjerrë nga diskutimet virtuale dhe fizike të organizuara nga Germin me anëtarë të diasporës:

1. Të fillojë të implementohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e Diasporës. Kësisoj, të krijohet sa më parë Komisioni i përbashkët, i paraparë me nenin 10 të kësaj marrëveshjeje. Ky komision, të jetë mekanizëm i përbashkët nga të dyja Qeveritë për këshillimin dhe mbikëqyrjen e mësimin plotësues në diasporë;
2. Të krijohet një fond i përbashkët i Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë, i cili do të financonte aktivitetet për promovimin e mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë, përfshirë edhe sigurimin e materialeve mësimore dhe kompensimin e mësimdhënësve aty ku shtetet pritëse nuk e ofrojnë këtë. Financimi për këto aktivitete të saktësohet me ligjin e ri të Diasporës, të iniciuara nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë apo me vendim të veçantë;
3. Të hartohet sa më parë kurrikula e përbashkët e mësimin plotësues në gjuhën shqipe nga institucionet përkatëse në bashkëpunim me mësimdhënësit në Diasporë dhe e njëjta të aprovohet nga dy qeveritë;
4. Të përditësohen librat dhe materialet e tjera pedagogjike për arsim bazuar në nevojat e gjeneratave të ndryshme, dhe kësioj programi të zhvillohet me metoda dhe mjete duke ju përshtatur niveleve të ndryshme të arsimit, në mësimdhënie dhe mësim nxënie;

5. Të krijohen përmes zyrtarëve të ambasadave, projekte për kualifikimin e mësimit në diasporë të diasporës përkthazi me kurrikulën e re të përbashkët e cila duhet hartuar/aprovuar nga dy qeveritë ;
6. Mësimit në diasporë shqiptarë që japin mësimit plotësues në gjuhën shqipe të ju njihet përvoja e punës, si një veprim incentivizues që inkurajon mësimit në diasporë. Kjo të saktësohet me ligjin e ri të Diasporës nga Republika e Kosovës dhe Shqipërisë;
7. Të dërgohen atashe në ambasadat shqiptare apo kosovare nga dy Qeveritë (Kosovës dhe Shqipërisë) në diasporë për të ndihmuar në organizimin dhe monitorimin e mësimit plotësues në gjuhën shqipe, si dhe lidhur me zbatimin e marrëveshjes ndërshtetërore mes Kosovës dhe Shqipërisë; si dhe
8. Të promovohen programe shkëmbimi në fushën e hulumtimit mes studentëve shqiptarë jashtë vendit dhe atyre në Kosovë;
9. Programe dhe fushata vetëdijësues për fëmijët e diasporës dhe prindërit me qëllim që të ngritet numri i nxënësve në shkollat shqipe. Fushatat duhet të promovohen më shumë edhe përmes kanaleve televizive si Radio Televizioni i Kosovës, mediave lokale në shtetet rezidente, rrjeteve sociale etj.

REFERENCAT:

- [1] "Mësimi Plotësues Në Diasporë." *Ballina / MASHT*, Ministria e Arsimit Shkencës Dhe Teknologjisë, www.masht.rks-gov.net/mesimi-plotesues-ne-diaspore-1
- [2] "Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në fushën e Diasporës", <http://www.diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/VKM-59-fusha-e-diaspores.pdf>
- [3] "Kurrikula e Shkollës Shqipe Të Mësimit Plotësues Në Diasporë." *Ministria e Arsimit, Shkencës Dhe Teknologjisë*, Nov. 2007. <http://med.rks-gov.net/desk/inc/media/19AE26ED-92B7-4C72-B091-E096BF51DE57.pdf>
- [4] [8] International Bureau of Education, Publication on Croatia, N.A. 2010 http://www.ibe.unesco.org/fileadmin/user_upload/Publications/WDE/2010/pdf-versions/Croatia.pdf
- [5] [7] [9] "Sweden: Mother Tongue Theme Site" Swedish National Agency for Education, OECD, <http://www.oecd.org/education/ceri/SWE.TC.SystemNote.pdf>
- [6] "National Curriculum Framework for Preschool Education and General Compulsory and Secondary Education" Ministry of Science, Education and Sports, Jul. 2010, http://www.ibe.unesco.org/curricula/croatia/ci_fw_2010_eng.pdf



Powered by:
 germin

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Ky grant është financiar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financiar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).